



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.560/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Andnan Konushevci kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Gjemail Shkodriqi, me vendbanim në Zvicër, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET e pa rregullt ankesa Anr.560/2021, e datës 02.03.2021, e parashtruar nga Gjemail Shkodriqi, me vendbanim në Zvicër, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

A r s y e t i m

Me datën 02.03.2021, Paneli ka pranuar apelin Anr.560/2021, të parashtruar nga Gjemail Shkodriqi nga Zvicra, mirëpo të njëjtit apel nuk i ka bashkangjitur asnjë pretendim rreth apelimt.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i paraqitur nga Gjemail Shkodriqi, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: “*Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim*”. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet per kontaktim të personit që e dorëzon apelimin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt

- c) hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk ajnë në posedim të parashtruesit të apelimit
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.560/2021 më datën 03.03.2021.

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevci



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.